



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

RAPORTIMI VJETOR MBAJTUR PËRPARA
KOMISIONIT PARLAMENTAR TË EKONOMISË

Mbi
Veprimtarinë e AMF-së
gjatë vitit 2009

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARISË SË AMF-SË -2009

Të nderuar deputetë,

kam nderin të paraqes sot përpara para jush një ekspozitë të veprimtarisë, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) gjatë vitit 2009 dhe projektet e tij në funksion të përballimit me sukses të sfidave të zhvillimit të tregjeve financiare jo-bankare.

AMF filloi aktivitetin e tij rreth tre vite më parë, duke integruar funksionet e kryera nga rregullatorët e mëparshëm në fushat e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private suplementare dhe vjen sot si rezultat i një pune intensive 3-vjeçare në kuadrin e një programi afatmesëm me produkte konkrete në fushën rregullatore, mbikëqyrëse, të teknologjisë, atë kooperuse e konsolidimit institucional.

Viti 2009 ishte një vit me zhvillime të rëndësishme në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes dhe konsolidimit të legjislacionit rregullues të tregjeve financiare jo-bankare. Veprimtaria e AMF-së është udhëhequr nga misioni i saj themelor, që është **mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe publikut në tërësi**, e lidhur ngushtë me **stabilitetin financiar të operatorëve të mbikëqyrur**.

Viti 2009 rezultoi me një arkitekturë të re në sigurime, me miratimin e 5 ligjeve të reja e një sërë aktesh nënligjore, me një sërë produktesh të teknologjisë e informacionit, si qendra e të dhënave të dëmeve motorike krahas asaj të shitjes e raportimit në kohë reale të policave motorike, me përgatitjen dhe licencimin e profesionistëve e ndërmjetësve të ndryshëm financiarë, me zhvillimin e koncepteve të reja të mbikëqyrjes financiare, në kontributin e pyetësorit e dokumenteve të MSA-së, me nr. jeshil në ndihmë të konsumatorit, me nënshkrim të dy MoU-ve mjaft të rëndësishme: ajo multilaterale e IOSCO-s (Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Letrave me Vlerë) si dhe me FMA-në (Autoriteti Rregullator Mbikëqyrës i Austrisë) për fushën e sigurimeve.

Të nderuar deputetë,

Gjatë vitit 2009, **Tregu i sigurimeve pati vëmendjen kryesore dhe fokusimin e pjesës më të madhe të burimeve dhe kapaciteteve të AMF-së, duke qenë se mban peshën kryesore në tregun financiar jo-bankar në Shqipëri.** Autoriteti

ka analizuar dhe monitoruar situatën financiare të tregut të sigurimeve dhe në veçanti të shoqërive të sigurimit, duke pasur si prioritet gjatë ushtrimit të funksioneve të tij përmirësimin e procesit të mbikëqyrjes së këtij tregu.

Raporti i depozituar në Kuvend, në muajin mars 2010, për pjesën e analizës financiare është bazuar në masë të madhe në të dhënat e tregut për 9-mujorin e vitit 2009, ndërsa të dhënat statistikore i përkasin periudhës janar-dhjetor 2009.

Shifrat dhe faktet pozitive për vitin 2009, tregojnë për **stabilitet dhe rritje të qëndrueshme** të tregut të sigurimeve **me një strukturë tashmë më të diversifikuar dhe të balancuar.**

Penetrimi i sigurimeve i shprehur në përqindje të PBB-së, gjatë 2009, ishte 0.67%, krahasuar me 0.65% në vitin 2008. Pavarësisht rritjes së tregut vitet e fundit, ky raport thekson faktin se tregu i sigurimeve ka ende shumë vend për rritje të mëtejshme drejt konsolidimit dhe synimit minimalisht të niveleve të krahasueshme me rajonin.

- Gjatë vitit 2009, vijuan të ushtrjnë veprimtarinë dhjetë shoqëri sigurimi, nga të cilat shtatë shoqëri të sigurimit të Jo-Jetës, dy shoqëri të sigurimit të Jetës dhe një shoqëri kompozite e Jetës dhe Jo-Jetës. Gjashtë shoqëri kanë pronësi vendase, ndërsa katër të tjerat kanë njëkohësisht pronësi vendase dhe pjesëmarrje influencuese të huaj. (*Interalbanian është në proces të ndryshimit të pronësisë me kapital 100% vendas*).
- Gjatë vitit 2009, numri i kontratave të sigurimit dhe i të ardhurave nga primet kanë pothuajse të njëjtat ritme rritjeje 10% dhe 11% përkatësisht, fakt që dëshmon për rritjen reale të tregut, si rezultat kryesisht i rritjes së numrit të klientëve.
- Gjatë vitit 2009, evidentohet përsëri tendenca e tre viteve të fundit: dinamika e lartë e rritjes të sigurimeve vullnetare (21%), gjë që shënon një

përmirësim cilësor të strukturës së tregut në favor. (53% / 47%) Sigurime vullnetare.

- Vazhdojnë të lidhen ngushtë me nivelin e kreditimit nga sistemi bankar dhe investimet e mëdha infrastrukturore.
- Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës dominoi sigurimi i zjarrit dhe reziqeve natyrore me rreth 27%, të pasuara nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me rreth 21%, sigurimi kasko me rreth 21% dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.
- Ritmet më të larta në vitin 2009 i patën primet në sigurimet e Jetës me rreth 40%, ku kontributin kryesor këtu e ka dhënë portofoli “Jetë Debitori” me 43%.
- Futja e investitorëve të huaj në treg këto vitet e fundit, ka pasur ndikimet e veta në drejtim të prezantimit të një game të re produktesh vullnetare, të cilat po gjejnë hapësirat e duhura në treg.
- **Pavarësisht zhvillimeve pozitive, niveli i ulët i penetrimit dhe raporti i ulët dëme/prime (32% në nëntëmujorin 2009), faktojnë se tregu i sigurimeve ka ende shumë për të bërë në drejtim të rritjes së besimit të konsumatorit dhe përmirësimit të shërbimit në tërësi.**
- Numri i automjeteve të pasiguruara është i madh duke renduar kostot e shoqërive, që në fund të fundit reflektohet në dëmshpërblimet e të siguruarve.

AMF, në kuadër të krizës financiare globale, ka ndjekur një strategji të kujdesshme për të monitoruar, parandaluar dhe reaguar ndaj efekteve negative të krizës financiare në tregun financiar shqiptar të mbikëqyrur prej tij. Në përputhje me këtë strategji, janë evidentuar risqet me ekspozim më të lartë ndaj efekteve të krizës ndërkombëtare duke konsideruar skenarët e mundshëm si dhe reagimin përkatës, janë orientuar shoqëritë e sigurimit drejt masave për mbrojtjen ndaj risqeve me

ekspozim më të madh, janë kërkuar raportime më të shpeshta dhe të detajuara nga tregu dhe institucione të tjera shtetërore, në lidhje me të dhënat financiare, portofolin e investimeve dhe risqet madhore, janë kryer takime në kuadër të Grupit të Stabilitetit Financiar, pjesëmarrës të të cilit janë AMF, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, për të marrë në konsideratë situatën dhe koordinimin e aktiviteteve, etj.

Në zbatim të përgjegjësive ligjore si Autoritet Mbikëqyrës e në funksion të misionit të tij themelor, atë të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, AMF realizon funksionin e vet mbikëqyrës nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane, bashkërendimit të analizave financiare dhe mbikëqyrjes në vend të tregut, orientimit të mbikëqyrjes drejt mbikëqyrjes me bazë risku, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, trajnimit të burimeve njerëzore drejt një mbikëqyrje efektive, etj

Projekti “Për Mbikëqyrjen Efektive” me BB, që filloi që në vitin 2008, ka për qëllim hartimin e metodologjisë së mbikëqyrjes, duke kaluar në një përjasje me bazë riskun. Puna intensive e stafit profesional ka finalizuar:

- projekt-manualet e mbikëqyrjes, duke prezantuar konceptet e reja të një mbikëqyrje me bazë riskun, i cili do të shërbejë si një bazë procedurale për stafin mbikëqyrës të AMF në marrjen e vendimeve gjatë procesit të vlerësimit të riskut dhe analizës financiare të shoqërive të sigurimit;
- si dhe përshtatjen e legjislacionit në fushën e sigurimeve.

Objektivat kryesorë të këtij procesi janë:

- ❖ Promovimi i një tregu eficient sigurimesh, të sigurt dhe të qëndrueshëm, me qëllim mbrojtjen e policëmbajtësve.
- ❖ Hartimi i metodologjive efektive të mbikëqyrjes me bazë risku dhe të një platforme mbikëqyrjeje efikase.
- ❖ Rritja e kapaciteteve të AMF, për të vlerësuar risqet e pjesëmarrësve të tregut, përdorimi eficient i burimeve dhe vendosja e prioriteteve të ndërhyrjes.
- ❖ Forcimi i kuadrit rregullativ dhe i mbikëqyrjes së sigurimeve.

- ❖ Rritja e kapaciteteve rregullative dhe institucionale të AMF, si dhe
- ❖ Rishikimi i bazës ligjore për tregun e sigurimeve.

Në ndihmë të funksionit të vet mbikëqyrës, një nga projektet e rëndësishme që AMF ndërmori që në vitin 2007, ishte ai i ngritjes së Qendrës Kombëtare të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik. Gjatë 2009 është realizuar me sukses faza e dytë e ngritjes së Regjistrimit të Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike. Sistemi i ndërtuar, në bashkëpunim me Shoqëritë e Sigurimeve, përpunon tërësinë e informacionit të nevojshëm si pjesë e aktivitetit të institucionit, ndërkohë që garanton stabilitet, siguri dhe vazhdueshmëri të proceseve të punës së pjesëmarrësve të tregut. Gjithashtu, kjo qendër krijon një premisë të domosdoshme drejt liberalizimit të primeve të sigurimit të detyrueshëm, kërkesë kjo edhe e direktivave.

Në kuadrin e këtij projekti është ndërtuar dhe është në mirëmbajtje “Motori i kërkimit të policave për institucionet”, i cili mundëson kërkimin e policave nëpërmjet aksesit të sigurt nga faqja e internetit e Autoritetit dhe me rezultat dhënien e konfirmimit të mbulimit në sigurim me Karton Jeshil ose TPL për automjetet shqiptare apo të mjeteve të huaja me Policë Kufitare.

Me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e transparencës së veprimtarisë së sigurimeve të detyrueshme, AMF gjatë vitit 2008 ka bërë të mundur kërkimin nga qytetarët të vlefshmërisë të policave në përkatësi. Autoriteti projektoi, ndërtoi dhe ka në mirëmbajtje “Motorin e kërkimit të policave për qytetarët”, i cili mundëson kërkimin e policave nëpërmjet faqes së internetit të Autoritetit (<http://www.amf.gov.al/mtpl.asp>) dhe me dhënien e konfirmimit të mbulimit në sigurim me Karton Jeshil ose TPL për automjetet shqiptare apo mjeteve të huaja me Policë Kufitare.

Një angazhim tjetër intensiv gjatë 2009, për stafin e AMF-së, ka qenë puna për zbatimin e projektit të financuar nga BERZH-i “Management Information System” (MIS). Projekti nga ana teknike përbëhet nga një platformë raportimi në baze web, nëpërmjet së cilës operatorët e mbikëqyrur raportojnë në mënyrë elektronike të dhënat financiare e statistikore të kërkuara periodikisht nga Autoriteti në mbështetje të bazës ligjore në fuqi. Gjatë vitit 2009, është bërë një punë intensive për finalizimin e këtij projekti, i cili mendohet të jetë i gatshëm për testim nga tregu, në gjysmën e dytë të vitit 2010.

AMF, në funksionin e mbikëqyrjes në vend, ka kryer 13 inspektime gjatë vitit 2009, në të tre sektorët e mbikëqyrur. Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, janë kryer inspektime të përbashkëta tematike në bankat e nivelit të dytë për verifikimin e: depozitave të kompanive të sigurimit, llogarive rrjedhëse të tyre, kredive të marra nga shoqëritë e sigurimit, kontratat e sigurimit të kredive, si edhe kolaterat e garantuara prej tyre.

Po kështu, në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis dy rregullatorëve financiarë AMF dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), u organizua nga Drejtorati i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve të BQK një inspektim i përbashkët në një nga shoqëritë shqiptare të sigurimit të Jo-Jetës, që ka shtrirë aktivitetin e saj edhe në Kosovë.

Gjatë vitit 2009, përveç procedurës kryesore të mbikëqyrjes së Autoritetit, nëpërmjet inspektimeve apo analizave financiare, tematika e inspektimeve është identifikuar edhe nga një sërë burimesh të tjera, duke përfshirë këtu edhe ankesat.

Mbështetur në gjetjet, problematikën apo mangësitë e konstatuara nga këto inspektime në tërësi, Bordi i AMF-së, mori vendime që kishin të bënin me marrjen e masave apo vendosjen e sanksioneve ndaj shoqërive të sigurimit, si dhe me dhënien e rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit.

Gjatë vitit 2009, Bordi i Autoritetit ka vendosur për shoqëritë e sigurimit: 11 masa korrigjuese, 6 urdhra për raportim, 1 kufizim shpërndarje fitimi, 4 sanksione me gjobë dhe 3 sanksione me gjobë për personat përgjegjës pranë shoqërive, si dhe 2 refuzime licencash për ndërmjetësim në sigurime; për institutet private të pensioneve: 2 masa korrigjuese. Në total për vitin 2009 janë vendosur 6.9 milionë lekë gjoba.

Gjatë vitit 2009, në disa raste ka qenë e nevojshme ndërhyrja e Autoritetit nëpërmjet masave administrative, me qëllim eliminimin e shkeljeve duke siguruar kthimin në gjendje të shëndoshë të subjekteve të mbikëqyrura, konform legjislacionit në fuqi.

Mbajtja e komunikimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit me institucionet homologe të rajonit e më gjerë, janë të domosdoshme në drejtim të përmbushjes së rolit rregullativ të AMF, për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jo- bankare.

(ii) Tregu i letrave me vlerë:

Edhe gjatë **vitit 2009, tregu i letrave me vlerë u dominua** nga tregu me pakicë i instrumenteve të borxhit të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione).

Në tregun me pakicë të letrave me vlerë operojnë 5 banka si shoqëri brokerimi dhe njëkohësisht si regjistrarë, Posta shqiptare dhe një shoqëri brokerimi. Përveç tyre, 3 banka të tjera janë licencuar për të operuar si broker në Bursën e Tiranës, si dhe një shoqëri brokerimi. Gjithashtu, Qendra e Regjistrimit të Aksioneve mbetet shoqëri e licencuar nga Autoriteti për të regjistruar aksionet e shoqërive aksionare.

Platforma GSRM tashmë ka tre vite që është projektuar dhe ndërtuar nga AMF, në mënyrë të tillë që të sigurojë rritje të transparencës në lidhje me kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë, duke synuar mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve. Ky objektiv është realizuar me sukses, pasi platforma tashmë funksionon normalisht dhe një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe ndërgjegjësimi i lartë i subjekteve të licencuara nga AMF për të operuar në këtë treg, në lidhje me përfitimet nga transparenca dhe publikimi në kohë reale i të dhënave mbi kuotimet dhe transaksionet e ekzekutuara çdo ditë.

(iii) Tregu i pensioneve private vullnetare mbetet ende një treg i vogël, parë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për vitin 2009, shihet një rritje prej 37% e kontributeve dhe një rritje prej afër 15% e numrit të kontribuesve, krahasuar me vitin 2008. Numri i kontribuesve në vitin 2009 kapi shifrën 4,429 me një total kontributesh prej 73 mln lekë. Zhvillimi më i rëndësishëm në këtë treg për vitin 2009, ka qenë hyrja në fuqi e Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, “*Për fondet e pensionit vullnetar*”, i cili sjell përmirësimin e bazës ligjore për kolonën e tretë të fondeve private të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara.

Aktiviteti rregullues

Në kuadër të funksionit rregullues të AMF-së, si dhe të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007-2012, një ndër angazhimet kryesore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2009 ka qenë plotësimi i kuadrit ligjor. Kështu, gjatë vitit 2009, si rezultat i një pune dhe kooperimi 3-vjeçarë dhe përpjekjeve për transpozimin e direktivave përkatëse, janë finalizuar 4 ligje të reja:

- **Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;**
- **Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar";**
- **Ligji nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive";**
- **Ligji nr. 10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore".**
- **Si dhe në fillim të vitit 2010, Ligji për marrjen e paketës kontrolluese të shoqërive publike.**

Dy ligjet e investimeve kolektive (Ligji "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe Ligji "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive") vendosin për herë të parë administrimin e fondeve kolektive në përgjegjësi të shoqërive administruese të licencuara për këtë qëllim, sipas standardeve ndërkombëtare dhe kërkesave aktuale në këtë fushë.

Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" erdhi si nevojë e zbatimit të detyrave të caktuara nga Marrëveshja e Asocim-Stabilizimit dhe sjell përmirësimin e bazës ligjore për kolonën e tretë të fondeve private të pensioneve, të pensionit vullnetar me kontribute të përcaktuara, duke ndryshuar skemën aktuale të funksionimit të kolonës së tretë. Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009, synon përmirësimin e sistemit ekzistues të pensioneve vullnetare në Shqipëri nëpërmjet:

- lehtësim në planin afatgjatë të kostove sociale duke stimuluar shtetasit të kursejnë privatisht dhe vullnetarisht për të shtuar pensionin e tyre;
- shtimin e nivelit të kursimit të popullatës dhe rritjen e investimeve afatgjata në vend.

Në tërësi dhe në detaje, ligji vendos standardet e nevojshme për administrimin me efektivitet të fondeve të pensioneve private në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e anëtarit të fondit të pensionit, të nxitet qëndrueshmëria, siguria dhe mirëqeverisja e aseteve të fondit të pensionit.

Ligji nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" plotësoi kuadrin ligjor në fushën financiare, fokusuar në tregun e titujve, si një domosdoshmëri që i përgjigjet zhvillimeve aktuale në vend. Ai synon të krijojë një ambient të përshtatshëm dhe të rregulluar për të nxitur zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Vënia në zbatim e këtij ligji gjatë vitit 2010 do të krijojë hapësirën e duhur për zhvillimin dhe rritjen e tregut të titujve. Një nga objektivat kryesorë të tij është të sigurojë një mbrojtje efektive të interesave të investitorëve, të cilët nxiten nga ofertat e operatorëve të këtyre sipërmarrjeve. Për këtë qëllim, parashikon ndalimin e promovimit të, reklamimit, tregtimit, ose ofertën për shitje të kuotave apo aksioneve të një sipërmarrjeje investimi kolektiv pa autorizimin e AMF-së.

Ligji nr. 10158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore" u hartua në kuadër të ndryshimeve që pësoi legjislacioni Shqiptar në lidhje me ligjin publik financiar dhe tregtar, veçanërisht në lidhje me ligjet e reja të aprovuara "Ligji për Titujt" dhe "Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Ky ligj është në përputhje me direktivat evropiane dhe ka një strukturë, e cila lejon lehtësi të modernizimit të mundshëm duke përfshirë dispozita për tipe të reja të huave të obligacioneve, sipas tendencave ndërkombëtare dhe kërkesave të tregut vendor.

Në legjislacionin aktual është parashikuar mbrojtja e interesave të aksionarëve të shoqërive tregtare. Për analogji, në këtë ligj janë parashikuar rregulla që mundësojnë mbrojtjen e interesave të mbajtësve të obligacioneve, organizimin dhe vendimmarrjen e tyre në grup për çështje që lidhen me emetimin e obligacioneve, vlerën, interesin dhe maturimin e tyre, çlirimin e kolateraleve apo të garancive që jepen si element sigurie, apo të drejtën për të pasur një agjent. Këto rregulla krijojnë një rregullim ligjor të plotë e praktik për shoqëritë aksionare dhe njësitë e qeverisjes vendore që do të ushtrojnë veprimtari në tregun e obligacioneve.

Vlen të theksohet fakti, që në hartimin e këtyre ligjeve, një vëmendje e veçantë i është kushtuar përafrimit me direktivat/rregulloret e BE, si dhe parimeve të IOPS dhe IOSCO. Në hartimin e këtyre ligjeve, AMF ka bashkëpunuar me ekspertë të Bankës Botërore, Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), organizatën FSVC të USAID, si dhe ka marrë asistencë të vlefshme ligjore vendase.

Gjithashtu, gjej rastin të nderuar deputetë, të përshëndes kontributin tuaj dhe t’ju falënderoj për të gjithë angazhimin që keni treguar në shqyrtimin dhe miratimin e këtyre ligjeve shumë të rëndësishëm në funksionimin e tregjeve financiare jo-bankare.

Të nderuar deputetë,

Pavarësisht punës intensive me projektet ligjore të sipërpërmendura, gjatë vitit 2009, AMF ka punuar edhe për rishikimin dhe plotësimin e akteve nënligjore në të tre sektorët. Gjatë vitit 2009, Bordi i AMF-së miratoi 11 rregullore dhe 4 ndryshime në rregulloret ekzistuese, ku midis të tjerave vlen të përmendet: Rregullorja "Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike", "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", "Mbi licencimin e aktuarëve të autorizuar të shoqërive të sigurimit", "Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", "Mbi mënyrën e miratimit, financimit dhe administrimit të buxhetit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit" e shumë rregullore të tjera që synojnë përmirësimin e bazës ligjore në tregjet e mbikëqyrura nga AMF.

Me Vendimin nr. 20, datë 19.03.2010, Bordi miratoi Rregulloren "Mbi masën e kontributit vjetor të shoqërive të sigurimit". Kjo rregullore synon të rregullojë masën e kontributit të derdhur nga shoqëritë e sigurimit, si dhe procedurën e axhustimit me mbylljen e pasqyrave financiare në varësi të planit financiar dhe realizimit të tij.

Një vend të rëndësishëm të punës gjatë vitit 2009, zuri dhe procesi i Integritetit Evropian.

Në procesin e dhënies së përgjigjeve të Pyetësorit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ishte pjesëmarrës aktiv duke dhënë kontributin e tij në më shumë se 10 kapituj. Për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare” AMF ishte koordinator i grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e përgjigjeve në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë. Në procesin e plotësimit të pyetësorit u përfshinë mbi 20 specialistë të AMF, ndërsa disa nëpunës të tjerë u përfshinë në procesin e grumbullit të informacionit, ndihmë teknike për portalin, etj.

Procesit të dhënies së përgjigjeve të pyetësorit i parapriu një periudhë përgatitore, sikundër ishin takime dypalëshe apo shumëpalëshe ndërmjet Ministrisë së Integritit, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare apo me ministri të tjera, koordinatorë të kapitujve dhe grupeve ndërinstitucionale të punës. Autoriteti nëpërmjet strukturës së tij menaxhuese dhe koordinuese ka punuar për koordinimin dhe mbarëvajtjen e këtij procesi me institucione të tjera shtetërore të përfshirë në dhënien e përgjigjeve, për të shmangur çdo vonesë apo pasaktësi në dhënien e përgjigjeve.

Angazhime të ngjashme ka pasur edhe për raportin periodik Trade Policy Review e dokumenta të tjera në kuadrin e plotësimit të angazhimeve që burojnë edhe nga anëtarësimi në OBT.

Aktiviteti licencues

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në ushtrimin e funksionit licencues, ka pasur parasysh edhe konkluzionet e G20 mbi nevojën e standardizimit dhe uniformitetit të rregullimit ligjor përmes sektorëve të ndryshëm të sistemit financiar, pavarësisht se mund të ekzistojnë diferenca legjitime ndërmjet sektorëve.

AMF është kujdesur që kërkesat dhe procedurat e licencimit, të zbatuara për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë aktivitet në tregun financiar jo-bankar, të jenë të qarta, objektive dhe transparente, e pa krijuar diferencime parimore.

Aktiviteti licencues u fokusua drejt profesionistëve, ndërmjetësve apo ofruesve të shërbimeve si: licencim i brokerave dhe shoqërive të brokerimit në sigurime, licencim i agjentëve në sigurime, licencim i vlerësuesve të dëmeve në sigurime, i kujdestarit në letra me vlerë; si dhe në miratime të ndryshimeve statutore dhe miratime të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura.

Aktet nënligjore mbi përcaktimin e kriterëve të licencimit të profesioneve në fushën e sigurimeve, si profesioni i brokerit në sigurime, profesioni i vlerësuesit të dëmeve, apo profesioni i aktuarit, kanë përcaktuar si kusht licencimi edhe kalimin me sukses të testimit për njohuritë në fushën përkatëse në kombinim me etikën profesionale dhe legjislacionin.

Gjithashtu, këtë vit është riaktivizuar kursi dy vjeçar i trajnimit për profesionistë të kësaj fushe, asistuar nga USAID, i cili do të përgatisë ekspertë të ardhshëm në fushën e aktuaristikës, profesion, i cili është shumë i rëndësishëm në mbarëvajtjen e tregut të financiar. AMF kërkon edhe mbështetjen tuaj për ta evidentuar këtë profesion kaq të rëndësishëm për sekt financiar, sidomos me vendosjen në fokus administrimin e risqeve.

Veçanërisht, në kuadrin e rritjes së profesionalizmit të profesionistëve që merren me vlerësimin e dëmeve në sigurime, Autoriteti në maj 2009, miratoi modulet bazë që duhet të përmbajë programi i trajnimit të këtij profesioni.

Rritja e prezencës së kapitalit të huaj është konsoliduar gjatë vitit 2009, ku “Vienna Insurance Group” tashmë zotëron 87% +1 të aksioneve në shoqërinë e sigurimit “SIGMA” sh.a, ndërsa UNIQA International Beteiligungs-Verëaltung GmbH zotëron 68.65% të aksioneve të “Sigal Holding” sh.a (zotëruese e kapitalit të shoqërisë Sigal dhe Sigal-Life). Interesi i investitorëve të huaj vazhdon të jetë në rritje, ku mund të përmendet Grupi Slloven Triglav, që ka shpallur interes për pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë Albsig.

AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të mbikëqyrësve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensioneve (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë. Gjithashtu, AMF vijon të jetë pjesëmarrëse me kontribut aktiv, në Nënkomitetin e Bazës së të dhënave të Ligjeve të IAIS-it, i cili lidhet me shkëmbimin e përvojave të vendeve të ndryshme, hartimin dhe njësimin e standardeve për t’u zbatuar më tej nga të gjithë vendet anëtare.

Viti 2009 shënoi dhe kurorëzimin me sukses të një pune intensive për t’u bërë pjesë e Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit me IOSCO-n. Kështu, në qershor 2009, gjatë Konferencës së 34-Vjetore të Organizatës Ndërkombëtare të

Autoriteteve të Letrave me Vlerë (IOSCO), AMF nënshkroi Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit me IOSCO-n duke u bërë anëtare e organizatës me të drejta të plota. Nënshkrimi i marrëveshjes hap rrugën e madhe të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me institucionet homologe në mbarë botën, duke shënuar një hap të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të tregut të letrave me vlerë në Shqipëri.

Konsolidimi i interesave Austriake në tregun Shqiptar të sigurimeve ka hapur rrugën e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencës midis AMF dhe **Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë**. Ky bashkëpunim i suksesshëm midis dy institucioneve është konkretizuar në muajin korrik 2009, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Ministrisë Austriake të Financave e Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë, në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve. Nënshkrimi i marrëveshjes është një hap strategjik tepër i rëndësishëm për AMF dhe mbi të gjitha është shprehje e bashkëpunimit institucional në mbikëqyrjen e përbashkët dhe shkëmbimin e informacionit midis rregullatorëve financiarë të të dy vendeve.

AMF ka vijuar të mbajë bashkëpunim të ngushtë, në mënyrë të vazhdueshme me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në përmbushje të misionit të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, me qëllim rritjen e efektivitetit të rregullimit të tregjeve financiare në Shqipëri.

Bashkëpunimi me **Ministrinë e Financave** gjatë vitit 2009 ka qenë tepër i rëndësishëm dhe i suksesshëm, në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor të tre sektorëve që mbikëqyren nga AMF dhe veçanërisht në organizimin e takimeve të punës për diskutimin me institucionet shtetërore të projekteve ligjore të hartuara nga AMF.

Bashkëpunimi me **Bankën e Shqipërisë** është shumë i rëndësishëm në drejtim të arritjes së objektivave të përbashkëta për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare në vend. Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit midis dy institucioneve dhe inspektimet e përbashkëta kanë rezultuar të suksesshme, duke konfirmuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi strategjik në drejtim të evidentimit të risqeve dhe transferimit të tyre brenda sektorit financiar.

Të nderuar deputetë,

AMF, gjatë vitit 2009, ka punuar në mënyrë të pandërprerë për rritjen e cilësisë së informacionit dhe transparencës, **komunikimit efektiv me publikun** dhe edukimit financiar në përmbushje të rolit themelor: *Mbrojtjes së konsumatorit*.

Gjatë vitit 2009, Autoriteti ka shtuar mjetet e tij në mënyrë që të vazhdojë t'i sigurojë konsumatorit gjithë informacionin e nevojshëm, transparencën e vazhdueshme, me synimin që konsumatori të jetë komod në vendimet që do të marrë në lidhje me zgjedhjen e tij.

Duke shtuar mjetet e komunikimit me konsumatorin, gjatë vitit 2009, janë trajtuar një sërë ankesash, ku përfshihen dhe sqarime, çështjet kryesore të cilat kanë të bëjnë me vonesat e trajtimit të dëmshpërblimeve, refuzimin e ngjarjes së sigurimit, sqarime apo shkelje të kushteve të kontratave të sigurimit, ndryshim të rrethanave të ngjarjes së sigurimit, përlllogaritjen e masës së dëmshpërblimit, etj. Nga këto ankesa janë zgjidhur përfundimisht rreth 60% e tyre.

AMF praktikon një sërë formash dhe mënyrash në përmbushjen e një komunikimi efektiv me publikun, ku mund të përmenden fletëpalosjet që përmbajnë informacion edukativ dhe statistikor të strukturuar, në lidhje me tregjet nën juridiksionin e AMF-së. Gjithashtu, publikimet e ndryshme me karakter informativ dhe edukativ kanë synuar njohjen e konsumatorëve me tregun financiar jo-bankar, mënyrën e funksionimit të tij, mbështetur dhe nga një faqe interneti interaktive, e cila e përmbush më së miri funksionin e saj në drejtim të komunikimit me të gjitha palët e interesit. Është zgjeruar gama e botimeve statistikore, si gjeografia e sigurimeve, etj. për të cilat ka interes në rritje.

AMF ka pasur një prezencë aktive në median e shkruar e elektronike, si një instrument për të komunikuar zhvillimet e rëndësishme në tregjet financiare jo-bankare apo dhe për të qenë palë në dialogun mes grupeve të interesit për zhvillimin e këtyre tregjeve. Media e shkruar dhe elektronike ka shërbyer

gjithashtu për të përcjellë mesazhin e AMF-së publikut, në funksion të fushatave sensibilizuese, në drejtim të mbrojtjes dhe ndërgjegjësimit të konsumatorit.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të paraqes përpara jush në mënyrë të përmbledhur edhe disa çështje që kanë të bëjnë **me, forcimin e kapaciteteve institucionale të AMF-së.**

Edhe gjatë vitit 2009, Autoriteti vazhdoi të funksionojë sipas strukturës dhe organikës së miratuar në bazë të Vendimit nr. 98, datë 30.04.2007.

Organika e AMF-së, e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, është 58 punonjës, dhe ka nevojë që në bazë të VKM-së të miratojë këtu edhe kategoritë e specialistëve, gjë që s'ka ndodhur akoma dhe kërkojmë mbështetjen tuaj.

Viti 2009, shënoi financimin e aktivitetit të AMF-së tërësisht nga burimet e veta. Në këtë kuadër, duhet të përmend, se disa kufizime që lidhen me numrin e punonjësve, strukturën dhe sistemin a pagave, ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetet, efektivitetin dhe rritjen e ekspertizës së AMF-së, për më tepër që tashmë AMF ka arritur pothuajse pavarësi të plotë financiare. Këto kufizime ulin mundësinë e absorbimit të ekspertëve aq të pakët në këtë profil dhe unë shpresoj që kjo çështje thelbësore për funksionimin e AMF-së të gjejë vëmendjen dhe trajtimin tuaj.

Të nderuar deputetë,

Përmbushja dhe realizimi i objektivave dhe prioriteteve të AMF-së është një proces i vazhdueshëm. Viti 2009 ka qenë një vit intensiv në këtë drejtim, duke i hapur rrugën një sërë prioriteteve për periudhat në vazhdim. Më poshtë dëshiroj të përmbledh disa prej tyre:

- Përafrimi i legjislacionit të fushës me atë të Bashkimit Evropian, në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së

Stabilizim-Asociimit, strukturimi i zhvillimit të tregjeve sipas standardeve dhe mbrojtja e konsumatorit, mbeten objektivat kryesorë, që përbëjnë dhe fokusin e punës së AMF-së në të ardhmen.

- Puna e vazhdueshme për hartimin e të gjitha akteve nënligjore në mbështetje të ligjeve të reja që kanë hyrë në fuqi gjatë vitit 2009.
- Licencimi i fondeve dhe shoqërive të administrimit të fondeve, si rrjedhojë e aprovimit të ligjit të fondeve të pensionit dhe investimit.
- Tendencat globale të largimit nga mbikëqyrja tradicionale drejt asaj me bazë risku, janë përkrahur nga AMF dhe janë përkthyer në një punë intensive me mbështetjen e Bankës Botërore, për të kaluar në një mbikëqyrje më efektive të tregut të sigurimeve në Shqipëri, në fokus të së cilës do të jetë risku dhe për rrjedhojë përdorimi më efikas i burimeve të kufizuara. Përfundimi i hartimit të manualit të integruar të mbikëqyrjes me fokus risku, ku përveç elementëve me bazë risku janë përfshirë dhe raportet e paralajmërimeve të hershme është një objektiv shumë i rëndësishëm për t'u realizuar gjatë vitit 2010. I gjithë ky proces ka hyrë në fazën finale dhe po mbështetet nga Banka Botërore.
- Përmirësimi i raportimit dhe futja në zbatim e *Sistemit të Menaxhimit të Informacionit* në bashkëpunim me BERZH-in, është një tjetër prioritet për vitin e ardhshëm.
- Fillimi i punës për ngritjen e sistemit bonus-malus, në kuadër të një liberalizimi të ardhshëm të tregut të MTPL.
- Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit është një element kyç në përmbushjen e funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës të AMF-së. Forcimi i mëtejshëm dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucione brenda dhe jashtë vendit, do të jenë në fokusin e vazhdueshëm të AMF-së për periudhat në vijim.

- Fushatat edukuese dhe nxitëse për publikun, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare, në linjë me rritjen e cilësisë së instrumenteve për mbrojtjen e konsumatorit, kanë qenë dhe do të vijojnë të jenë objektiva strategjike të AMF-së, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe integritetit të tregjeve financiare jo-bankare.
- Rritja e vazhdueshme e kapaciteteve institucionale dhe i nivelit të ekspertizës, politika e motivimit të stafit, nxitjes së profesionistëve, aktivitetet dhe trajnimet e ndryshme, janë pjesë e strategjisë së AMF-së, por që kufizohen ndjeshëm nga situata aktuale e strukturës së pagave. Një vështrim pozitiv i kësaj çështje, sidomos në kushtet e financimit të institucionit në masën 100% me fondet e veta, do të kishte ndikim të ndjeshëm në efektivitetin dhe ecurinë afatgjatë të institucionit.

Dhe se fundi, doja të shprehja mirënjohjen dhe vlerësimin për kontributin e gjurmët që ka lënë në institucion z. K. Gjika, si nënkryetar, si dhe A. Qamo si këshilltarë e aktuarë e AMF-së. Largimi i tyre nga institucioni krijon një boshllëk që zor se mund të zëvendësohet me të njëjtën etikë e profesionalizëm të lartë .

Shpreh vlerësimet e konsideratat për anëtarët e bordit të cilët u janë përgjigjur shumë situatave të vështira apo urgjente, me profesionalizëm e përgjegjshmëri të lartë me efekte në vendime të drejta e të paanshme.

Stafi ekzekutiv mjaft i dedikuar ka punuar sa herë në kushte presioni, kohë dhe shpesh në kushte jo shumë të përshtatshme të zyrave-apartamente apo në pamundësi shpërblimi. AMF si institucion që duhet të veprojë në përputhje me standardet e përcaktuara për këto rregullatorë dhe në kushtet e vetëfinancimit, do të kërkonte hapësira më të mëdha, sidomos financiare, për të pasur statusin që i takon dhe që do të kishte një efekt direkt në cilësinë e stafit .

Ju falenderoj për mbështetjen, vëmendjen.

Elisabeta GJONI
KRYETAR